

PUNONJËSIT SOCIALË

PËR TË RINJTË NË VËSHTIRËSI

Udhëzues





Ambasciata d'Italia
Tirana



“Punonjësit socialë për të rinjtë në vështirësi”

Ky material është përgatitur nga Shoqata Kombëtare e Punonjësve Social (SHKPS) në kuadër të projektit “Qëndro”. Projekti “Qëndro” financohet nga Qeveria Italiane dhe zbatohet nga UNICEF në Shqipëri.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë material nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të UNICEF Shqipëri dhe të Qeverisë Italiane.

Rreth Udhëzuesit

Udhëzuesi fokusohet në përfshirjen sociale, barazinë gjinore dhe mbrojtjen sociale dhe është në shërbim të punonjësve socialë dhe profesionistëve të shërbimeve sociale si një metodë pune me të rinjtë në vështirë dhe në rrezik të braktisjes së sistemit arsimor.



PUNONJËSIT SOCIALE *PËR TË RINJTË* NË VËSHTIRËSI

Një sistem i strukturuar mirë i mbrojtjes sociale, i mbështetur nga një kuadër ligjor dhe shërbime efektive, luan një rol kyç në nxitjen e rritjes, zhvillimit dhe mirëqenies së të rinjve në çdo shoqëri. Në këtë udhëzues gjithëpërfshirës, ne sjellim aspektet e sistemit të mbrojtjes sociale dhe të kuadrit ligjor të shërbimeve sociale që mbështesin strukturat fuqizuese për të rinjtë. Udhëzuesi fillon me një eksplorim të kuadrit ligjor dhe institucional të mbrojtjes sociale, duke nxjerrë në pah parimet thelbësore për mbështetjen e aktiviteteve rinore dhe rolin e institucioneve të ndryshme bazuar në legjislacionit ekzistues.

Në këtë udhëzues ofrimi i shërbimeve rinore shikon edhe përtej kërkesave ligjore dhe institucionale; për të fuqizuar të rinjtë është e nevojshme që të jemi të pajisur me aftësi dhe shprehje që lehtësojnë komunikimin efektiv, ndërtimin e marrëdhënieve dhe sigurojnë mirëqenien emocionale të përfituesve të rinj. Gjithashtu, në këtë udhëzues, ne shqyrtojmë rolin kritik të komunikimit, verbal dhe joverbal, së bashku me dhënien dhe marrjen e reagimeve, aftësitë negociuese dhe ndërtimin e partneritetit.

Një temë tjetër që trajtohet në këtë udhëzues është menaxhimi i rasteve për trajtimin e të rinjve në vështirësi, duke hedhur dritë mbi parimet e punës për mbështetjen e të rinjve, ndikimin tek shëndeti mendor tek të rinjtë dhe menaxhimin efektiv të rasteve.

Gjithashtu, sfera e kërkimit shkencor dhe metodave të aktivizmit social është një temë që trajtohet në këtë udhëzues për të eksploruar se si mjete dhe strategji të ndryshme mund të shfrytëzohen për të fuqizuar dhe angazhuar të rinjtë brenda komuniteteve të tyre. Së bashku, këto aspekte të ndërlidhura formojnë një pamje tërësore të fushës shumëplanëshe të punës sociale me të rinjtë, duke ofruar njohuri dhe udhëzime të vlefshme për ata që janë të përkushtuar të kenë një ndikim pozitiv në jetën e brezit të ardhshëm.

Tabela e PËRMBAJTJES

SISTEMI I MBROJTJES SOCIALE DHE KUADRI LIGJOR I SHËRBIMEVE

Kjo pjesë ofron njohuri për punonjësit social dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve që punojnë me të rinjtë në institucionet vendore mbi kuadrin ligjor dhe politikat për të rinjtë.

AFTËSITË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR TË RINJTË

Kjo temë ka si qëllim të sjellë forma të reja të qasjeve për të komunikuar me të rinjtë duke patur në fokus komunikimin fuqizues si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme për të krijuar rrjetin e sistemit të ndihmës për të rinjtë.

MENAXHIMI I RASTIT PËR TRAJTIMIN E TË RINJVE NË VËSHTIRËSI

Kjo pjesë ka si qëllim që të të përforcojë njohuritë e punonjësve sociale për menaxhimin e rasteve me të rinjtë në vështirësi. Studime rasti do të përfshijnë situata të lidhura me sigurinë e të rinjve duke përfshirë: sigurinë fizike dhe online, shëndetin mendor dhe të gjitha format e dhunës.

KËRKIMI SHKENCOR DHE METODAT E AKTIVIZMIT SOCIAL NË PUNËN ME TË RINJTË NË KOMUNITET

Në këtë pjesë trajtohet procesi i njohjes dhe vlerësimit të nevojave, si hapi i parë dhe më i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve efektive dhe të bazuara në nevojat e komuniteteve

PËRFUNDIME

Kjo pjesë përfshin disa udhëzime dhe mesazhe për profesionistët e shërbimeve sociale.



SISTEMI I MBROJTJES SOCIALE DHE KUADRI LIGJOR I SHËRBIMEVE

Kjo pjesë ofron njohuri për punonjësit social dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve që punojnë me të rinjtë në institucionet vendore mbi kuadrin ligjor dhe politikat për të rinjtë.

Çështje kryesore:

- Kuadri ligjor në lidhje me mbrojtjen sociale;
- Konteksti politik, institucional dhe social i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023;
- Parimet e ligjit Nr.75/2019 për Rininë për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve në Shqipëri;
- Institucionet përgjegjëse për rininë sipas legjislacionit në fuqi;
- Përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për rininë;
- Të rinjtë përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror.



Përkufizime

- Fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç. (Ligj Nr. 121/2016 Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë)
- Të rinj janë personat, i ri ose e re, që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç. (Ligji Nr. 75/2019 “Për Rininë”)
- I mitur është çdo person nën moshën 18 vjeç. (Ligj Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”)

Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike që adresojnë çështjet e grupeve në nevojë dhe në vështirësi. Megjithatë, zbatimi i politikave sociale për përfshirjen e grupeve vulnerabël, mbetet problematik. Gjatë punës së tyre në ofrimin e shërbimeve për të rinjtë në situata të vështira punonjësit socialë duhet t'i referohen një sërë ligjesh dhe dokumentash me qëllim ofrimin e shërbimeve efektive për të rinjtë në vështirësi.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor për çdo qytetar në Republikën e Shqipërisë. Në nenin 54 pika 1 sanksionohet që fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.



Kushtetuta përcakton gjithashtu objektivat sociale ku në nenin 59 përcaktohet se shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

- a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
- b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
- c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
- ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë.

Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

Ligji Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” përcaktojnë se sigurimi dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë të moshuarit, është përgjegjësi e njësive të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht për:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal,
- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore,
- Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ligj Nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”



Ligj Nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Ky ligj udhëhiqet nga parimi i drejtësisë sociale ku çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

Strategjia Kombëtare Për Barazinë Gjinore 2021-2030

Strategjia Kombëtare Për Barazinë Gjinore 2021-2030 përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t'u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; si dhe ku grupet e cënueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës.

Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025

Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 në disa prej qëllimeve strategjike synon të adresojë edhe nevojat të të rinjve të tilla si: Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara; Sigurimi dhe ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara; Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin; Ofrimi i një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm e të përballueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+ 2021 – 2027

Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+ 2021 – 2027 shërben si një udhërrëfyes drejt një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo diskriminuese për të gjithë personat LGBTI+, të cilët kanë lirinë e qenit vetvetja; trajtohen në mënyrën e duhur, sipas standardeve të zbatueshme kombëtare të harmonizuara me ato ndërkombëtare; kanë qasje në shërbime publike cilësore apo shërbime mbështetëse të specializuara, të disponueshme në mbarë vendin dhe në përputhje me nevojat specifike të tyre; si dhe marrin pjesë aktivisht në të gjitha fushat e jetës, pavarësisht shprehjes së identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të seksit apo tërësisë së karakteristikave të tjera individuale të tyre.

Ligj Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

Ligj Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 është një dokument kombëtar i cili është një angazhim i Qeverisë së Shqipërisë për të përmbushur të drejtat e fëmijëve në Shqipëri me një kohështrirje 2021–2026.

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021-2025

Plani Kombëtar prezanton një përshkallëzim të masave dhe parashikon nisjen e aktiviteteve të reja për nxitjen e integritetit të nisjen e aktiviteteve të reja për nxitjen e integritetit të Romëve dhe Egjiptianëve në sektorët e punësimit, strehimit, arsimit, shëndetit, regjistrimit civil, mbrojtje sociale dhe mos-diskriminim.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2020–2023



Strategjia Kombëtare e Rinisë 2020–2023 është një dokument ku bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument synon hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zëjet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm, etj.

Ligj Nr. 75/2019 “Për Rininë”



Ligj Nr. 75/2019 “Për Rininë” ka si objektiva kryesore mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.



Konteksti politik, institucional dhe social i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023



Politika për zbutjen e varfërisë, krijimi i kushteve që individët, familjet dhe fëmijët në situata të vështira të përballojnë efektet që shkakton varfëria, vulnerabiliteti dhe përjashtimi është prioritet kyç i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e politikave të Mbrojtjes Sociale në Republikën e Shqipërisë.

Strategjia reflekton angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale, duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar, burrë, grua, djalë apo vajzë, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore, të cilat rikonceptohen me prioritet familjen dhe duke adresuar “qasjen e ciklit të jetës”.



KUADRI INSTITUCIONAL

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni kryesor, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes, kujdesit dhe integritetit të individëve dhe grupeve në nevojë. Shërbimi Social Shtetëror institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është përgjegjës për zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e politikave kombëtare të kontributit dhe përfitimit të kujdesit shëndetësor, për të gjitha grupet përfituese.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave kombëtare të kontributeve dhe përfitimeve.

Sipas Reformës Territoriale të miratuar nëpërmjet ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë dhe bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, sigurimi dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë të moshuarit, është përgjegjësi e njësive të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht për:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal,
- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore,
- Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Parimet e Ligjit nr.75/2019 për Rininë për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve në Shqipëri

Ky ligj garanton mbrojtjen e të rinjve shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të të rinjve shtetas të huaj ose persona pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt.

Parimet për mbështetjen e veprimtarisë së të rinjve

Mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi;
- b) parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritetit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve;
- c) parimin e lirisë së organizimit të iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave;
- ç) parimin e subsidiaritetit.

Institucionet përgjegjëse për rininë sipas legjislacionit në fuqi

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është një institucion i krijuar në vitin 2021 dhe që ka peshën kryesore e themelore në organizmin dhe mbështetjen e rinisë. Ai është përgjegjës për politikën e përgjithshme rinore dhe kuadrin ligjor, monitorimin e zbatimit të politikave rinore dhe përfaqësimin e Qeverisë së Shqipërisë në nivel ndërkombëtar në lidhje me çështjet që lidhen me rininë.

Ministria e Arsimit dhe Sportit deri në vitin 2021 ka pasur edhe portofolin e rinisë dhe ishte përgjegjëse e plotë për politikën rinore. Një zëvendësministër i përkushtuar për Rininë ishte pjesë jetike e kuadrit të përgjithshëm të politikave për të rinjtë ndërsa Drejtoria për Rininë në kuadër të kësaj ministrie ishte përgjegjëse për çështjet që lidhen me politikën rinore. Kjo ministri vazhdon të ketë një rol të rëndësishëm në politikën rinore sepse mban përgjegjësi për dy fusha të rëndësishme në jetën e të rinjve 15 – 29 vjeç, siç janë arsimi dhe sporti.

Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për raportet e të miturve në konflikt me ligjin.

Ministria e Kulturës është përgjegjëse për artin dhe politikat kulturore që synojnë edhe rininë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për shëndetin e të rinjve dhe përfshirjen sociale.

Gjithashtu organet e administratës shtetërore, organet e vetëqeverisjes lokale dhe OJF-të janë aktorë të rëndësishëm përgjegjës për rininë.

Qeveritë e studentëve/nxënësve dhe subjekteve të tjera juridike me qëllim të përmirësimit të statusit të të rinjve, zhvillimit të tyre personal dhe social, si dhe përfshirjes së tyre në çështjet sociale.

Institucionet e tjera qendrore

Institucionet e tjera qendrore, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, kanë për detyrë:

- a) të hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore të nevojshme për të drejtat e të rinjve, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndërsektoriale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të të rinjve;
- b) të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të të rinjve;
- a) të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të të rinjve.

Përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për rininë

Bashkitë, sipas Ligjit për Rininë, kanë tashmë një punonjës të specializuar për çështjet rinore. Ato po ashtu, në varësi të madhësisë së tyre, zakonisht kanë një Drejtorin ose Njësinë për Shërbimet Sociale, ku përfshihen përgjegjësitë për çështjet që lidhen me rininë. Në nivel lokal, qendrat rinore janë një platformë thelbësore për fuqizimin e të rinjve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:

- a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
- b) krijimin e këshillit vendor të rinisë;
- c) organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
- ç) organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- d) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- dh) financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
- e) krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- ë) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
- f) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

Funksionet ekskluzive të njësive administrative për mirëqenien sociale:

Sipas ligjit të organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor **Njësitë Administrative** janë përgjegjëse për:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë të popullsisë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, pleqtë
- Ndërtimin e banesave sociale
- Krijimin dhe administrimin e faciliteteve për sigurimin e shërbimeve lokale
- Aplikon për të marrë fonde nga fondi social bazuar në planet sociale lokale dhe nevojat e grupeve në nevojë.

Njësia Administrative ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke:

- identifikuar nevojat;
- vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit;
- hartuar planin social vendor;
- programuar buxhetet vendore;
- planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;
- kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror
- bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.

Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë njësive administrative ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror.

- Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit.
- Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë.
- Bashkitë, me numër popullsie më pak se gjashtë mijë banorë, orientohen dhe mbështeten në funksionet e tyre nga zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Të rinjtë përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror

Nga pikëpamja moshore masat e formuluar në politikat për të rinjtë janë parë në lidhje dhe me përputhshmërinë me tri grupe moshore, të cilat përputhen edhe me ciklet e zhvillimit edukativo profesional si vijon:

- 15 – 18 vjeç: arsimi i mesëm i lartë ose arsim profesional
- 19 - 24 vjeç: arsimi universitar, zhvillim i mëtejshëm profesional ose punësim
- 25 – 29 vjeç: arsim pasuniversitar ose punësim pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve


Qëllimet e këtyre politikave janë:

- Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.
- Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Bazuar në lëgjslacionin shqiptar disa nga kategoritë e të rinjve përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë:

Të rinj vulnerabël

Ata të rinj që janë në situata rreziku apo ndjehen të diskriminuar apo të përjashtuar për shkak të situatës ekonomike, gjinisë, orientimit seksual, përkatësisë etnike, prejardhjes, etj. Në masat e parashikuara në këtë strategji janë marrë parasysh edhe të rinjtë në kontakt me ligjin për shkak të pjesëmarrjes në aktivitete të paligjshme apo situatave të trafikimit.



Të rinj në familje me vështirësi ekonomike


Në këtë aspekt këta të rinj konsiderohen vulnerabël meqenëse ata jetojnë në varfëri dhe përballen me vështirësi ekonomike që janë të vështira për t'u kapërcyer. Kufizimet ekonomike janë pengesa për arsimimin, pjesëmarrjen në tregun e punës, sigurimin e punës dhe për sigurimin e mjeteve të jetesës.

Të rinj të paarsimuar ose me nivel arsimor bazë

Për shkak të faktit që të rinjtë e paarsimuar ose me nivele arsimore të ulëta kanë nivele të ulëta aftësish, gjë e cila bën që ata të përballen me më shumë vështirësi për gjetjen e një pune ose për pasjen e një pune të qëndrueshme që siguron të ardhura të mjaftueshme ose përfitime nga puna, ata janë më të prirur ndaj vulnerabilitetit dhe rrezikut të përjashtimit nga tregu i punës. Nivelet e ulëta të arsimimit shoqërohen me një vulnerabilitet më të madh si rezultat i të ardhurave të vogla dhe pasigurisë së punës në tregun e punës. Përveç kësaj, fëmijët nga familje me nivel të ulët arsimor janë në rrezik më të madh që edhe vetë të arrijnë një nivel të ulët arsimor, duke qenë për rrjedhojë në rrezik të madh për të mbetur vulnerabël.

Vajzat dhe nënat e reja

Vajzat janë subjekt i martesave të hershme më shpesh se djemtë në komunitetet të ndryshme apo në zonat rurale dhe si rezultat ato kanë më pak vite shkollimi dhe e braktisin shkollën më shpesh se djemtë. Nga pikëpamja e drejtësisë dhe barazisë gjinore masat janë formuluar duke marrë në konsideratë kushtet specifike për vajzat dhe gratë e reja për të përballuar më mirë sfidat e zhvillimit profesional dhe hyrjes në jetën familjare. Në të gjitha rastet masat e parashikuara ndërlidhen me politikat nxitëse gjinore dhe i shërbejnë fuqizimit të vajzave dhe grave të reja duke marrë në konsideratë edhe vajzat e bëra nëna apo martuar në moshë të hershme dhe ato që gjenden në situata vulnerabiliteti. Nga pikëpamja gjinore masat e parashikuara synojnë edhe rritjen e pjesëmarrjes së vajzave si në jetën sociale ashtu edhe në atë profesionale.



Të rinjtë me aftësi të kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara përballen me kufizime ekonomike dhe sociale, duke i vendosur ata në një pozitë vulnerabël. Disa persona me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi ekonomike sepse nuk përfshihen në tregun e punës dhe mbështeten vetëm tek përfitimet për personat me aftësi të kufizuara ose ndonjëherë nënvlerësohen dhe nuk u jepen këto përfitime.

Të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin

Të miturit që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë.

[illegible]



AFTËSITË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR TË RINJTË

Kjo pjesë ka si qëllim të sjellë forma të reja të qasjeve për të komunikuar me të rinjtë duke patur në fokus komunikimin fuqizues si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme për të krijuar rrjetin e sistemit të ndihmës për të rinjtë.

Çështjet kryesore

- Komunikimi & angazhimi: Krijimi i besimit (krijimi i një hapësirë të sigurt, angazhimi i prindërve/kujdestarëve, udhëzues i gjuhës së ndjeshme, komunikimi verbal dhe jo verbal)
- Intervistimi i fokusuar drejt zgjidhjes: për t'i ndihmuar ata të përqendrohen në pikat e tyre të forta, të krijojnë besim në aftësitë e tyre dhe t'i udhëheqin drejt zgjedhjeve pozitive.
- Partneriteti- ndërtimi i marrëdhënieve: qasjet e praktikave më të mira në punën me të rinjtë, prindërit/kujdestarët e tyre dhe profesionistë të tjerë, ndihmon punonjësve socialë në mbledhjen e informacionit për vlerësime, duke punuar me rezistencë, përmirësimin e vendimmarrjes dhe rezultateve me të rinjtë dhe familjet e tyre .



Komunikimi:

Një aftësi kyçe e punës sociale

Punonjësit socialë komunikojnë me të rinjtë për një sërë arsyes. Ata komunikojnë drejtpërdrejt me të rinjtë për të mësuar më shumë rreth tyre dhe rrethanave të familjeve të tyre. Ata gjithashtu komunikojnë me ta për të përcaktuar pikëpamjet e tyre për vendimet dhe çështjet që ndikojnë jetën e tyre. E thënë thjesht, punonjësit socialë apo çdo profesionist që ofron shërbim social duhet të jenë në gjendje të lidhen, të angazhohen, të mbështesin, të flasin dhe të dëgjojnë të rinjtë nëse ata do të bëjnë një ndryshim pozitiv në jetën e tyre por jo vetëm.

Sigurisht, të rinjtë nuk komunikojnë të gjithë në të njëjtën mënyrë. Ata mund të kenë stilin e tyre të preferuar të komunikimit ose të kenë një nevojë të veçantë komunikimi. Punonjësit socialë/ profesionistët duhet të jenë në gjendje të komunikojnë drejtpërsëdrejti në të gjithë spektrin e moshës. Puna e tyre ka të ngjarë të përfshijë edhe të rinj që mund të kenë aftësi të kufizuara, apo çdo problem tjetër të cilat ndikojnë në komunikim.

Moshat dhe fazat e ndryshme të fëmijërisë, nevojat specifike dhe rrethanat e veçanta të të rinjve të ndryshëm, së bashku theksojnë se sa e rëndësishme është që punonjësit socialë të kenë aftësi të gjera dhe të forta komunikimi mbi të cilat mund të mbështeten. Por, komunikimi shkon përtej vetëm të folurit dhe dëgjimit të të rinjve.

Ai gjithashtu përfshin punonjësit socialë që përdorin një sërë metodash dhe teknikash si prekja, loja, nënshkrimi, gjuha e trupit, shkrimi, vizatimi, aktivitetet, përdorimi i simboleve dhe mjeteve të tjera të specializuara për t'u angazhuar dhe komunikuar me të rinjtë. (Winter et al, 2016).

Komunikimi i mirë është thelbësor në punën sociale në ofrimin e informacionit, mbështetjen, zgjidhjen e problemit dhe sjelljen e ndryshimit. Një komunikimi efektiv mbështet ndërtimin e marrëdhënieve dhe mbivendoset me shumë aftësi dhe vlera të tjera thelbësore të punës sociale. Komunikimi është një proces i dyanshëm që përfshin të folurit, dëgjimin dhe marrjen parasysh të shenja joverbale të zbuluara përmes gjuhës së trupit. Punonjësit socialë përdorin një sërë aftësish komunikimi në mbledhjen e informacionit, fitimin e perspektivat dhe ofrimi i informacionit të nevojshëm nga të tjerët.

Intervistimi i fokusuar drejt zgjidhjes: për t'i ndihmuar ata të përqendrohen në pikat e tyre të forta, të krijojnë besim në aftësitë e tyre dhe t'i udhëheqin drejt zgjedhjeve pozitive.

Intervistimi është përshkruar si "një bisedë me një qëllim". Ai përfshin një shkëmbim të strukturuar verbal të informacionit ndërmjet (të paktën dy) njerëzve. Në intervista, punonjësi social zakonisht merr rolin në udhëheqjen dhe drejtimin e bisedës drejt rezultateve specifike përmes përdorimit të pyetjeve.

Intervistat kanë një sërë qëllimesh në punën sociale dhe çdo intervistë mund t'i shërbejë një sërë qëllimeve të ndryshme të përshkruara më poshtë:



- **Kërkimi i informacionit:** Qëllimi kryesor këtu është marrja e informacionit. Do të ishte një qëllim kyç i një interviste me një përfitues potencial shërbimi për të identifikuar këndvështrimet e tij si pjesë e një vlerësimi.
- **Sigurimi i informacionit:** Qëllimi kryesor këtu është të ofrojë informacion që punonjësi social ka dhe i intervistuari jo. Kjo do të formonte qëllimin e intervistës nëse do t'i jepnit informacion për një shërbim një të mituri ose prindi.
- **Intervistë bindëse:** Këtu synimi është të sigurohet pranimi për një vendim mbi të cilin i intervistuari ka pak kontroll. Kjo mund të jetë pjesë e qëllimit tuaj për të shpjeguar se si dhe pse një i mitur p.sh duhet të marrë shërbime të shëndetit mendor.
- **Intervista terapeutike:** Kjo është në kontrast me intervistën bindëse, qëllimi është të mbështesë mirëkuptimin rreth ndjenjave ose rrethanave. Ky qëllim mund të përdoret në punën e drejtpërdrejtë terapeutike me përfituesit e shërbimit.

FLASIM DHE DËGJOJMË

Intervistimi mbështetet në aftësitë e komunikimit rreth të dëgjuarit dhe të folurit.

Dëgjimi është një proces aktiv përmes të cilit dëgjuesi synon të arrijë një kuptim të saktë të të gjitha mesazheve që personi tjetër po përcjell.

Të folurit është aftësia e vendosjes së informacionit kompleks në fjalë që përcjellin kuptimin e synuar.

Është e zakonshme në shkëmbimet e komunikimit që fjalët të keqkuptohen dhe të mos dëgjojmë me saktësi atë që thuhet. Çështjet e mbuluara nga ndërhyrjet e punës sociale dhe në intervista janë shpesh të ndjeshme dhe të dhimbshme, duke përfshirë ngjarje traumatike për ata që janë të përfshirë.

Në komunikim me njerëzit që janë të shqetësuar ose në krizë punonjësit socialë do të duhet të jenë në gjendje të:

- të menaxhojë dhe t'u përgjigjet momenteve të forta emocionale
- punë me rezistencë
- të komunikojë autoritetin dhe 'kontrollin' brenda ndërhyrjeve ligjore
- të komunikojë ngrohtësi dhe ndjeshmëri, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi të sigurt për një person të cenueshëm që të fillojë të eksplorojë çështje të vështira dhe të bëjë ndryshime me mbështetje

Përdorimi i komunikimit joverbal

Punonjësit socialë duhet të jenë në gjendje të përdorin aftësi joverbale në mënyrë që të demonstrojnë se po dëgjojnë në mënyrë aktive atë që komunikohet. Qëndrim i hapur i trupit, kontakt i mirë me sy dhe lëvizjet e kokës mund të përdoren për të siguruar folësin se ata kanë vëmendjen tuaj të plotë. Është gjithashtu e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm se po komunikohet shumë më tepër sesa ajo që thuhetfjalët.

Punonjësit socialë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të ndjeshëm ndaj tonit, qëndrimit dhe gjesteve, sjelljes, shprehjeve të fytyrës, veshjeve dhe paraqitjeve. Heshtja dhe qetësia janë gjithashtu forma të fuqishme komunikimi. Është vlerësuar se vetëm rreth 7% e asaj që komunikohet është vetëm përmes fjalëve (Rush, 1989 cituar në Stacks dhe Salëen, 2009); pjesa e mbetur komunikohet nëpërmjet sinjaleve joverbale dhe tonit të zërit.

Dhënia dhe marrja e komenteve

Në praktikë punonjësve socialë u kërkohet vazhdimisht të japin dhe të marrin reagime si për përdoruesit e shërbimeve ashtu edhe për kolegët. Feedback-u është një proces ndërveprues dhe shpesh përdoret pas vëzhgimeve për të informuar vendimet dhe për të mbështetur të nxënërit.

Aftësia për të dhënë komente që të tjerët mund të dëgjojnë, pranojnë dhe përdorin përmirësohet kur përdoren aftësitë e mëposhtme të komunikimit:

- Qartësia: sigurohuni që ajo që thoni të jetë e qartë
- Theksoni gjërat pozitive: shumica e njerëzve i shqyrtojnë komentet pozitive dhe përqendrohen në ato negative, kështu që pozitivet mund të kenë nevojë të ritheksohen
- Jini specifik: përshkruani sjelljet aktuale
- Jini përshkrues: tregoni atë që keni vërejtur
- Përqendrohuni tek sjellja dhe jo tek personi
- Pranoni se çdo sjellje mund të ndryshohet
- Zotëroni komentet: përdorni thëniet "Unë" p.sh. Vura re, pashë, dëgjova
- Përdorni gjuhë pozitive që sugjeron se problemi/vështirësia mund të zgjidhet
- Mbështetje për të kuptuar më mirë sesa për të dhënë këshilla.

Aftësia për të marrë komente është po aq e rëndësishme. Një qasje reflektuese ju mundëson të mësoni nga përvoja.

- Kur merrni reagime pozitive, sigurohuni që të keni një pikëpamje të ekuilibruar për të.
- A përputhet me provat, faktet?
- Çfarë supozimesh mund të ketë personi që i ka dhënë?

Reagimet pozitive mund të jenë një zbatues i fuqishëm i asaj që po arrijmë në praktikën profesionale, si dhe një mjet kryesor mësimor. Asnjë punonjës social nuk merr gjithçka siç duhet gjatë gjithë kohës.

Ka të ngjarë të ketë raste kur mund të merrni reagime negative ose një ankesë të bërë nga një përdorues shërbimi. Marrja e komenteve mund të jetë një mjet i shkëlqyer për të mësuar dhe për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

Disa këshilla për marrjen e reagimeve negative

- Gjithmonë përpikuni të veçoni atë që thuhet nga mënyra se si thuhet
- Kërkoni qartësi dhe shembuj rreth ankesës/reagimeve negative
- Mendoni për rolin tuaj në situatë dhe çfarë mund të bëni për ta përmirësuar atë. Kjo mund të nxjerrë në pah nevojat e të nxëniet që mund të adresohen përmes mundësive të ndryshme.
- Nëse ndiheni të mërzitur ose të zemëruar rreth kritikave, jepini vetes gjithmonë kohë për t'u qetësuar përpara se të përgjigjeni ose të veproni.

Aftësitë negociuese

Negocimi përfshin komunikimin në atë mënyrë që të arrihet një marrëveshje kur ka pikëpamje kontradiktore. Ajo kërkon një pamje të qartë të legjitimitetit dhe autoritetit të rolit të punonjës social dhe të qenit të qartë për shkallën në të cilën mund të pranohet terreni dhe ku është i mundur kompromisi dhe dakordësitë. Negociatat shpesh kërkojnë durim, këmbëngulje dhe qëndrueshmëri. Punonjës socialë shpesh e gjejnë veten duke negociuar me, ose në emër të, përdoruesve të shërbimeve. Negocimi mbështetet në aftësi të tjera komunikimi duke përfshirë të dëgjuarit dhe të folurit, të vëzhguarit, të reflektuarit dhe të analizuarit.

Suksesi në negociatat e punës sociale ka më shumë gjasa nëse pjesëmarrësit janë:

- të qartë për çështjet/mosmarrëveshjet: të qartë për kufijtë (kush është përgjegjës për çfarë),
- të përgatitur për të dëgjuar me mendje të hapur,
- të aftë për të vepruar me takt dhe paramendim,
- të përgatitur për kompromis,
- të aftë për të pohuar nevojat, dëshirat dhe ndjenjat e veta,
- të vetëdijshëm për dallimet në vlera dhe tradita kulturore,
- të qartë për rezultatet dhe mosmarrëveshjet e arritura,
- të aftë për të kryer angazhimet e marra.

Negociatat e suksesshme verbale në praktikën e punës sociale mund të rezultojnë në hartimin e një marrëveshjeje formale me shkrim mbi atë që është negociuar dhe ky mund të jetë një mjet praktik i dobishëm ku konfliktet ose pikëpamjet e kundërta janë të dukshme. Një marrëveshje se kush do të bëjë çfarë, kur, ku dhe si mund të ndihmojë në fokusimin e negociatave larg mosmarrëveshjeve drejt një zgjidhjeje. Çdo marrëveshje e shkruar ose plan veprimi duhet të përfshijë gjithashtu një rishikim të marrëveshjes.

Partneritetit - Ndërtimi i marrëdhënieve

Aftësia për të punuar në mënyrë efektive me të tjerët është thelbësore për praktikën e punës sociale. Kjo pjesë do ndihmojë të lidheni përsëri me disa nga parimet dhe vlerat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes që mbështesin një qasje partneriteti. Këtu do të përfshihen politikat aktuale dhe qasjet e praktikave më të mira në punën me të rinjtë, prindërit/kujfestarët e tyre dhe profesionistë të tjerë dhe do të nxjerrë në pah rolin e punonjësve socialë në mbledhjen e informacionit për vlerësime, duke punuar me rezistencë dhe në përmirësimin e vendimmarrjes dhe rezultateve me të rinjtë dhe familjet e tyre.

Përkufizimi i partneritetit mund të përfshijë tema rreth:

- ndarjes së pushtetit
- vendimmarrjeve të përbashkët
- njohjes së roleve dhe përgjegjësisë të ndryshme.

Sipas Tunnard (1991) "Thelbi i partneritetit është ndarja. Ai karakterizohet nga respekti për njëritjetrin, ndarjet e roleve, të drejtat për informacion, llogaridhënie, kompetencë dhe vlerë që i jepet kontributit individual. Shkurtimisht, çdo partner shihet se ka diçka për të kontribuar, pushteti ndahet, vendimet merren së bashku dhe rolet jo vetëm që respektohen, por gjithashtu mbështeten nga të drejtat ligjore dhe morale

Fuqia e këtij përkufizimi dhe arsyeja pse u zgjodh këtu, është se parimet që ai përshkruan mund të zbatohen në një sërë partneritetesh të punës sociale me palët e interesuara, duke përfshirë përdoruesit e shërbimeve si dhe me profesionistë të tjerë. Megjithatë, problemi me këtë përkufizim është se ai injoron dinamikën e pushtetit që mbështet shumë marrëdhënie të punës sociale. Pa një njohje të dallimeve në fuqi, realitetet e kompleksitetit të punës së partneritetit dhe praktikës bashkëpunuese nuk mund të kuptohen realisht.

Shkallët e pjesëmarrjes

Shkallët e ndryshme të pjesëmarrjes janë zhvilluar për të zbuluar nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes që negociohen brenda marrëdhënieve të punës sociale. Versioni i Hart (1992) është riprodhuar këtu për të dhënë një shembull. Në fund të shkallës nuk lejohet pjesëmarrja. Është vetëm në nivelin 4 që një shkallë e pjesëmarrjes është e pranishme në marrëdhënie. Në krye të shkallës fëmijët po ndajnë vendimmarrjen me të rriturit.

Të njëjtat parime të pjesëmarrjes mund të zbatohen edhe në marrëdhëniet e tjera të punës sociale. Duke u angazhuar me qëllimin e marrëdhënies, ju duhet të jeni në gjendje të gjeni llojin e pjesëmarrjes brenda standardeve dhe vlerave profesionale dhe ta promovoni këtë në marrëdhëniet tuaja me përdoruesit e shërbimit, kujdestarët e tyre dhe agjencitë e tjera.

Qëllimi i punës sociale


“Profesioni i punës sociale promovon ndryshimet sociale, zgjidhjen e problemeve në marrëdhëniet njerëzore e fuqizimin dhe çlirimin e njerëzve për të rritur mirëqenien. Duke shfrytëzuar teoritë e sjelljes njerëzore dhe sistemeve sociale, puna sociale ndërhyr në pikat ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre. Parimet e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale janë themelore për punën sociale.” (Federata Ndërkombëtare e Punonjësve Socialë, 2000)

Përkufizimi i Federatës Ndërkombëtare të Punonjësve Socialë thekson transaksionet që ndodhin midis njerëzve dhe mjedisit të tyre. Ai fokuson rolin profesional në zgjidhjen e problemeve dhe identifikon punonjësit socialë si agjentë të ndryshimit në shoqëri, në familje dhe në komunitet.

Roli i ndërtimit të marrëdhënieve është në qendër të punës sociale dhe përdoret për të sjellë përmirësime në situata individuale. Puna sociale është një profesion i drejtuar nga vlera që mbështetet nga vlerat profesionale të të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale.

Nevojitet një qasje reflektuese në praktikën profesionale së bashku me mbështetje të mirë.

Puna sociale ka një fokus të veçantë në:

- 
- Promovimin e aftësisë së njerëzve për të maksimizuar aftësitë e tyre
 - Inkurajimin e pjesëmarrjes në arsim, trajnim, punësim, aktivitete sociale dhe të kohës së lirë
 - Zhvillimin e aftësisë së njerëzve për të krijuar marrëdhënie pozitive brenda familjes dhe rrjetit social. Ndiheja e njerëzve për të krijuar dhe ruajtur pavarësinë
 - Ndiheja e njerëzve për të përfutur nga format alternative të mbështetjes që mbrojnë dinjitetin, të drejtat dhe zgjedhjet e tyre
 - Mbrojtjen e të drejtave të njeriut të njerëzve dhe promovimi i ushtrimit të të drejtave dhe përgjegjësisë të tyre si qytetarë (DH dhe DfES 2006, fq.49)

Lloje të ndryshme partneriteti


Punonjësit socialë dhe agjencitë e tyre nuk punojnë të izoluar. Të qenit i qartë për rolin tuaj profesional dhe bazën e vlerës do t'ju ndihmojë të komunikoni rolin, përgjegjësitë dhe qëllimin tuaj kur punoni me të tjerët për të sjellë ndryshim. Aktiviteti i mëposhtëm ju kërkon të mendoni për punën komplekse të bazuar në marrëdhënie në të cilën do të angazhoheni ndërsa ktheheni në praktikë dhe ju ndihmon të identifikoni disa nga njerëzit kyç me të cilët punonjësit socialë duhet të punojnë në partneritet kur punojnë me të rinjtë dhe familjet e tyre.

Inteligjenca emocionale dhe aftësitë e komunikimit

Puna sociale hyn në jetën e njerëzve kur ata janë në krizë, janë të shqetësuar dhe të pambrojtur dhe në situata komplekse kur ekzistojnë emocione shumë të ngarkuara. Shpesh informacioni ngatërrohet, njerëzit e përfshirë do të kenë nevoja kontradiktore dhe perspektiva të ndryshme, dhe polaritete do të ekzistojnë rreth nevojave, rreziqeve dhe vendimeve që duhet të merren.

Në fillim të kësaj pjese ne pamë se sa aftësitë komunikuese përfshijnë përdorimin e vetvetes dhe duhet të mbështeten nga inteligjenca emocionale dhe vetëdija e mirë.

Pikat e mëposhtme na sjellin në vëmendje disa elemente të rëndësishme të vetëdijes kur ndërhyini në jetën e njerëzve vulnerabël:

- 
- të kuptuarit e vetes, duke përfshirë shkaktarët emocionalë dhe përgjigjet e paracaktuara
 - të qenit rehat me punën me emocione të forta
 - ndërgjegjësimi për vlerat e veta
 - ndërgjegjësimi se si ju shohin të tjerët.

Punonjësit socialë duhet të zhvillojnë qëndrueshmëri profesionale. Në dhjetë këshillat e tyre kryesore për ndërtimin e qëndrueshmërisë emocionale në praktikën profesionale të punës sociale, Grant dhe Kinman (2012) rekomandojnë që punonjësit socialë të mbajnë një "ditar emocionesh" ku shkruajnë përvojat, ndjenjat e mendimeve. Ky bëhet një burim i vlefshëm personal që ndihmon për të dhënë njohuri se përse ndiheni ashtu si dhe për të ndihmuar në identifikimin e modeleve të sjelljes dhe reagimeve për të cilat duhet të jeni të vetëdijshëm. Kjo do të ndihmojë për të siguruar që kur punoni me përdoruesit e shërbimit, të qëndroni në mënyrë të përshtatshme empatike dhe ju ndihmon të dalloni fushat ku mund të keni nevojë për mbështetje të vazhdueshme.

[illegible]



MENAXHIMI I RASTIT PËR TRAJTIMIN E TË RINJVE NË VËSHTIRËSI

Kjo temë ka si qëllim që të të përforcojë njohuritë e punonjësve sociale për menaxhimin e rasteve me të rinjtë në vështirësi. Studime rasti do të përfshijnë situata të lidhura me sigurinë e të rinjve duke përfshirë: sigurinë fizike dhe online, shëndetin mendor dhe të gjitha format e dhunës.

Çështje kryesore:

- Parimet e punës për mbështetjen e të rinjve
- Shëndeti mendor dhe ndikimi tek të rinjtë
- Menaxhimi i rastit

Parimet e punës për mbështetjen e të rinjve

- parimi i barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi;
- parimi i mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritetit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve;
- parimi i lirisë së organizimit të iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave;
- parimi i subsidiaritetit.

Pikëpamja moshore - ciklet e zhvillimit edukativo profesional:

- 15–18 vjeç: arsimi i mesëm i lartë ose arsim profesional;
- 19–24 vjeç: arsimi i lartë, zhvillim i mëtejshëm profesional ose punësim;
- 25–29 vjeç: arsim pasuniversitar ose punësim pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve.

Problematikat që hasen tek të rinjtë sot janë si më poshtë:

- Martesat e hershme
- Bullizmi/krimi kibernetik
- Të rinj në konflikt/në kontakt me ligjin
- Migrimi i pasigurt
- Veprimtari sociale të pamjaftueshme
- Abuzim/shfrytëzim ekonomik/ trafikim
- Aftësia e kufizuar
- Shtatëzani e padëshiruar/sëmundje seksualisht të trasmetueshme (SST)/shëndeti riprodhues
- Përdorimi dhe shitja e lëndëve narkotike
- Problematika në familje/familje më një prind/prindër të divorcuar/etj.
- Shëndeti mendor
- Fëmijë të huaj të pashoqëruar

Vajzat dhe gratë



Nga pikëpamja e drejtësisë dhe barazisë gjinore - kushtet specifike për vajzat dhe gratë për të përballuar më mirë sfidat e zhvillimit profesional dhe hyrjes në jetën familjare.

Politikat nxitëse gjinore

i shërbejnë fuqizimit të vajzave dhe grave duke marrë në konsideratë edhe vajzat e bëra nëna apo martuar në moshë të hershme dhe ato që gjenden në situata vulnerabiliteti.

Nga pikëpamja gjinore

rritja e pjesëmarrjes së vajzave si në jetën sociale ashtu edhe në atë profesionale.

Krimi kibernetik dhe bullizimi midis të rinjve në formë kibernetike. Nga raporti i vlerësimit të PKVR 2015–2020, gjashtë indikatorë (60%) kanë mbetur të parealizuar në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale të të rinjve duke përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e informacioneve mbi dhunën, pabarazinë sociale, dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

- Mungesa e mjediseve të përshtatshme dhe të sigurta për lojën dhe aktivitetet fizike në komunitet.
- Numër i mjaftueshëm psikologësh dhe punonjësish socialë të specializuar në punën me të rinjtë nëpër gjimnaze, të cilët bashkëpunojnë me shërbimet sociale të bashkive dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.

Shëndeti mendor dhe ndikimi tek të rinjtë

Shëndeti mendor i të rinjve rrezikohet nga neglizhenca kundrejt problemeve të kësaj natyre por edhe nga lehtësia për të hyrë në rrjetet sociale ku të rinjtë ndeshen me elemente dëmtuese për shëndetin e tyre si varësia nga krahasimi me figura të njohura, qasja në materiale që janë të përshtatshme për të rinjtë, mungesa e kohës për tu kujdesur për vete, ngacmimet kibernetike dhe diskriminimet.

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19 dhe vështirësitë që shoqëruan procesin e kapërcimit të krizës së tërmeteve të vitit 2019 kanë lënë pasoja shëndetësore edhe mes të rinjve shqiptarë. Duket se dhënia e shërbimeve për të rinjtë (adoleshentët) dhe shërbimet miqësore e të orientuara nga të rinjtë janë ndërprerë që prej vitit 2015 në Shqipëri edhe pse strategjia e promovimit të shëndetit publik, shëndetit seksual dhe riprodhues dhe paketa bazë e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor (versioni i rishikuar) synojnë nevojat e të rinjve dhe adoleshentëve.

Strategjia e promovimit shëndetësor të vendit synon adoleshentët dhe të rinjtë duke rritur ndërgjegjësimin shëndetësor dhe duke krijuar mjedise mbështetëse për mënyra më të shëndetshme jetese, duke trajtuar çështje që përfshin ushqimin, veprimtarinë fizike, dhunën, pirjen e duhanit, alkoolin, drogën, shëndetin mendor, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe planifikimin familjar.

- Edukimi i adoleshentëve me aftësitë për jetën, duke përfshirë edhe informacionet për shëndetin, specifike sipas gjinisë dhe me ndjeshmëritë e dhura kulturore.
- Mungesa e shërbimeve të integruara shëndetësore për të menaxhuar adoleshentët abuzues me substancat (duhani, alkooli, drogat) dhe varësitë (përfshi edhe ato nga lojërat digjitale dhe pajisjet elektronike).
- Diskriminimi apo rreziku nga diskriminimi që përjetojnë grupe të rinjsh në shoqëri në bazë të gjinisë, moshës, orientimit seksual dhe etnisë.
- Bërjen e drejtësisë sociale bazuar në ndarjet rurale dhe urbane.

Baza ligjore orientuese për ofruesit e shërbimeve për kategori të caktuara të grupeve në vështirësi:

- Udhëzim nr. 252, datë 18.5.2021 për miratimin e “Standardeve minimale për shërbimet e përkujdesjes shoqërore për personat lgbti+ në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike, në Shqipëri”.
- Udhëzim nr. 582, datë 18.12.2017 për miratimin e “Standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, në qendrat shtëpi familje, për fëmijët 16–18 vjeç”.
- Urdhër nr. 792, datë 20.12.2019 për miratimin e “Standardeve të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror” të ofruara nga institucionet publike, organizata joqeveritare (OJF) ose entitete private për persona ose grupe të rrezikuara ose të prekura nga HIV/AIDS, turbekulozi dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme.
- Vendim nr. 518, datë 4.9.2018 për “Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial”, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.
- Vendim nr. 578, datë 3.10.2018 për “Procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit”, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes.
- Udhëzim nr. 262, datë 26.5.2021 për miratimin e “Metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës”.
- “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor”
- Vendim nr. 276, datë 12.5.2021 për miratimin e “Planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”.
- Vendim nr. 210, datë 6.4.2022 për miratimin e “Strategjisë kombëtare të shëndetësisë 2021-2030” duke përfshirë çështje të shëndetit mendor dhe shëndetit riprodhues.

Menaxhimi i rastit

Menaxhimi i rastit është metodologjia që siguron, hap pas hapi, ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për fëmijën në nevojë për mbrojtje dhe që synon të promovojë e të nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e tij.

Plan individual i mbrojtjes

Plani me veprime të caktuara, me qëllim mbrojtjen e fëmijës dhe parandalimin e cenimit të integritetit të tij, garantimin e të drejtave, mirëqenies, shëndetit dhe zhvillimit të tij, duke mbështetur familjen e fëmijës në realizimin e këtij plani, kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës.

Dhunë ndaj fëmijës: Është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

Modeli i menaxhimit të rastit i bazuar në ndërmjetësim.

Është një model i menaxhimit të rasteve që fokusohet në lidhjen e klientëve me burimet e komunitetit. Ky model thekson rëndësinë e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit.

Modeli i menaxhimit të rastit i bazuar në pikat e forta

Është një model i menaxhimit të rasteve që fokusohet në pikat e forta dhe aftësitë e klientit. Ky model thekson rëndësinë e ndërtimit mbi pikat e forta të klientit për t'i ndihmuar ata të arrijnë qëllimet e tyre.

Modeli i menaxhimit të rastit i bazuar në klinikë

Modeli i Menaxhimit të Rasteve Klinike është një model i menaxhimit të rasteve që fokusohet në nevojat mjekësore të klientit. Ky model thekson rëndësinë e koordinimit të kujdesit me profesionistë të tjerë, si mjekët dhe këshilltarët e shëndetit.

Në vëmendje të profesionistëve:

- Mbivendosja e moshës - qasja në menaxhimin e rastit
- Të rinj mbi 18 vjeç
- Elementët e mbrojtjes
- Ndikimi/roli i familjes në fuqizim
- Përfshirja vullnetare në menaxhim/këshillim i detyruar/vullnetar

[illegible]



KËRKIMI SHKENCOR DHE METODAT E AKTIVIZMIT SOCIAL NË PUNËN ME TË RINJTË NË KOMUNITET

Në këtë pjesë trajtohet procesi i njohjes dhe vlerësimit të nevojave, si hapi i parë dhe më i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve efektive dhe të bazuara në nevojat e komuniteteve. Hapat e këtij procesi dhe metodat për vlerësimin e nevojave për grupet rinore dhe veçanërisht për të rinjtë vulnerabël janë ndër çështjet më të rëndësishme që trajtohen në këtë sesion. Pjesë e sesionit janë edhe metodat e përdorimit të të dhënave në funksion të profesionistëve dhe të informimit publik;

Çështje kryesore:

- Metodatat e vlerësimit të nevojave për grupet rinore dhe veçanërisht për të rinjtë vulnerabël;
- Aftësi të analizimit të të dhënave dhe dokumentimi;
- Metoda të përdorimit të të dhënave në funksion të profesionistëve dhe të informimit publik.

Shqipëria është një nga vendet evropiane që vazhdon të ketë një popullsi të re. Regjistrimi i vitit 2011 regjistroi 705 mijë persona të moshës 15 - 29 vjeç ose 25% e popullsisë së përgjithshme. Duket se lindshmëria e ulët dhe emigracioni kanë ndikuar edhe në numrin e të rinjve në Shqipëri. Papunësia e përkohshme dhe afatgjatë tek të rinjtë ka një korrelacion edhe me një sërë pasojash të tjera, si rreziku i varfërisë, rritja e dëshirës për të emigruar, problemet e shëndetit fizik dhe mendor, krimi më i lartë, etj. Sipas një studimi të fundit, dëshira për të emigruar është në nivelet 60-70% tek të rinjtë e moshës 18-19 vjeç dhe arrin kulmin në moshën 28-30 vjeç duke arritur shifrën 81%. Tranzicioni i zgjatur dhe dinamikat e vendit drejt zhvillimit kanë vështirësuar sfidat e të rinjve, veçanërisht atyre që i përkasin grupeve vulnerabël për tu përshtatur me këto ndryshime.



Rëndësia e procesit të vlerësimit të nevojave

Procesi i vlerësimit të nevojave është një komponent shumë i rëndësishëm i qeverisjes së mirë në nivel vendor i cili mundëson shërbime të orjentuara drejt nevojave reale të komunitetit. Njohja e këtij procesi në çdo hap të tij është një bazë e mirë për të gjithë punonjësit në nivel vendor për të qënë më realist dhe efektiv në punën e tyre në krijimin, ofrimin, monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve të ndryshme qofshin ato sociale, ekonomike, infrastrukturore, etj.

Në një komunitet është e vështirë por jo e pamundur të identifikohen nevojat që kanë grupe të ndryshme qytetarësh pasi ato shpesh nuk kanë lidhje me njëra - tjetrën. Në raste të tjera qytetarët e kanë të vështirë të shprehin hapur shqetësimet e tyre, saqë ndonjëherë këto probleme ngelen të fshehta derisa të shfaqen në formën e krizave dhe emergjencave, si një problem i cili më pas prek të gjithë komunitetin. E gjitha kjo kërkon vendosjen e prioritetëve dhe planifikimin e ndërhyrjeve, të cilat do të ishin të padobishme pa një rifreskim të vazhdueshëm të informacionit rreth nevojave, kërkesave dhe dëshirave të qytetarëve.

Procesi i vlerësimit të nevojave të komunitetit është i domosdoshëm për përfshirjen e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e strategjive vendore. Njerëzit shpesh shfaqen rezistentë ndaj ndryshimeve, kjo sepse shpesh informacioni që ata kanë është jo i saktë, ose sepse ata nuk kanë qenë të përfshirë në marrjen e vendimeve. Vlerësimi i nevojave duhet parë si një proces i përfshirjes së qytetarëve për ti lejuar ata jo vetëm të mësojnë më shumë rreth situatës aktuale, por më e rëndësishmja, ti bëjmë ata të kuptojnë dhe ndjejnë se zëri i tyre është vendimtar në rezultatet dhe shërbimet që ata presin.

Përmes këtij procesi anëtarët e komunitetit marrin informacionin e nevojshëm lidhur me situatën reale në komunitet, duke rritur ndjeshëm nivelin e tyre të ndërgjegjësimit rreth problemeve të komunitetit dhe pasojave të tyre. Vlerësimi i nevojave ndihmon gjithashtu në vlerësimin sistematik të programeve ekzistuese dhe në planifikimin dhe përmirësimin e shërbimeve.

Procesi i vlerësimit të nevojave e ndihmon komunitetin si dhe drejtuesit vendor të:

- Identifikojnë nevojat për mënyrën sesi të shpërndahen shërbimet ekzistuese dhe planifikohen shërbimet e reja;
- Njohin opinionin publik në lidhje me objektivat dhe prioritetet që kanë qytetarët;
- Ndihmojnë në vlerësimin sistematik të programeve ekzistuese dhe planifikimet për përmirësimin e shërbimeve;
- Sigurojnë justifikime dhe shpjegime për kërkimin e buxheteve dhe grandeve;
- Rrisin ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth problemeve të komunitetit dhe efektet që këto probleme mund të kenë mbi komunitetin e tyre;
- Rrisin besimin dhe mbështetjen e qytetarëve në vendimet e qeverisjes vendore, dhe zhvillon një sens më të madh të “ndjenjës së përkatësisë” përmes përfshirjes publike;
- Rrisin ndërgjegjësimin në komunitet rreth planifikimit të përbashkët komunitar.


Të dhënat që mblidhen nëpërmjet procesit të vlerësimit të nevojave përdoren:

- për të kuptuar natyrën e problemit, karakteristikat, rëndësinë dhe pasojat e tij;
- për të siguruar informacion rreth shkaqeve dhe ndërhyrjeve të mundshme;
- për të dokumentuar ato nevoja që duhet të përfshihen në përshkrimin e problemit të një programi/politike të caktuar;
- për të dokumentuar nevojën për mbështetje të ndërhyrjeve dhe programeve të reja;
- për të përcaktuar se ku dhe nëse burime të tjera shtesë janë të nevojshme;
- për të siguruar informacion mbi planifikimin, krijimin dhe zhvillimin e shërbimeve apo programeve të reja;
- për të influencuar legjislacionin dhe politikat e ndryshme.

PROCESI I VLERËSIMIT TË NEVOJAVE

Si realizohet vlerësimi i nevojave në komunitet për grupet rinore dhe veçanërisht për të rinjtë vulnerabël?

Kush duhet të përfshihet në këtë proces? Vendimmarrësit vendor, punonjësit social, grupet rinore dhe veçanërisht të rinjtë vulnerabël, shoqëria civile, qytetarët që përfaqësojnë grupime të ndryshme duhet të inkurajohen të bëhen pjesë e këtij procesi. Në fazën përgatitore të procesit të vlerësimit të nevojave, një pjesëmarrje e gjerë e komunitetit do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë në rezultatet e tij. Në këtë moment slogani i duhur do të ishte “mos lini askënd të mbetet pas”, nëse e bëni ju do të dëgjoni më vonë kritika mbi gjithë procesin si dhe rezultatet e tij.



Një mënyrë e thjeshtë për të vlerësuar nevojat e një target grupi është intervistimi i përfaqësuesve të këtij targeti me qëllim marrjen e opinioneve dhe mendimeve të tyre në lidhje me zhvillimin e shërbimeve në komunitet, cilësinë e këtyre shërbimeve, si dhe çfarë shërbimesh të tjera të veçanta janë të nevojshme. Opinionet e tyre mund të shërbejnë/përdoren për të ndërtuar programe, të cilat do të synojnë ndryshimin e realitetit për këtë target grup, bazuar në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të komunitetit, në bashkëpunimin e organizatave dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë proces.

Procesi i vlerësimit të nevojave fillon me planifikimin dhe organizimin e fazave të punës; mbledhjen e të dhënave; analizimin dhe shpërndarjen e rezultateve që kanë dalë nga vlerësimi i nevojave; si dhe me ndarjen e këtyre rezultateve përmes forumeve publike për të lehtësuar planifikimin e ndërhyrjeve, të veprimit në komunitet.

Procesi i vlerësimit të nevojave kalon në disa faza:

Hapi 1: Ngritja e një grupi pune (punonjës vendor, ekspertë të fushës etj)

Hapi 2: Përcaktimi i fushës apo çështjeve që do adresohen (grupet rinore dhe veçanërisht të rinjtë vulnerabël)

Hapi 3: Përcaktimi i komunitetit të cilit po i drejtohem (kush është zona, qyteti, fshati, lagja)

Hapi 4: Përcaktimi i metodës/ teknikës së vlerësimit (çfarë metode vlerësimi do të përdoret cilësore apo sasore, çfarë instrumenti pyetësori, intervista, fokus grupe, vëzhgime, etj)

Hapi 5: Zhvillimi i një plani veprimi/pune (kush do bëjë çfarë, kur, ku dhe si)

Hapi 6: Zbatimi i metodave të përzgjedhura (mbledhja e të dhënave, kryerja e vlerësimit - e pyetësorëve, vëzhgimit, etj,)

Hapi 7: Analizimi i rezultateve

Hapi 8: Raportimi i gjetjeve (bërja të ditur e rezultateve të gjeneruara te palët e interesuara si kryetari/ia i.e bashkisë/njësisë administrative, donatorit etj)

Duhet mbajtur gjithmonë në vëmendje që procesi i vlerësimit të nevojave duhet të jetë një proces gjithpërfshirës nëpërmjet takimeve apo aktiviteteve të përbashkëta të aktorëve kyç të komunitetit sipas fushës dhe problematikës që po vlerësohet.

Gjatë takimeve të përbashkëta me të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e vlerësimit të nevojave është e nevojshme të:

- Mblidhen informacione më të zgjeruara rreth organizatave dhe institucioneve, që ofrojnë shërbime për target grupin e synuar;
- Rishikohen të dhënat dhe dokumentat, që tregojnë ose dëshmojnë historikun e zhvillimit të problemit në fjalë;
- Ndahen pritshmëritë dhe përqasjet e secilit aktor lidhur me realizimin e procesit të vlerësimit të nevojave;
- Identifikohen dhe diskutohen me përfituesit e mundshëm të programeve, që do të krijohen për adresimin e nevojës së identifikuar.

Metodologjia e realizimit të procesit të vlerësimit të nevojave

Metodologjia është i gjithë procesi që hartohet për të identifikuar se cilat janë hapat që duhen ndërmarrë për të mbledhur të dhënat e nevojshme. Përpara fillimit të punës për procesin e vlerësimit të nevojave është e rëndësishme të:

- Identifikohen pjesëmarrësit, që do të jenë pjesë e vlerësimit;
- Identifikohet strategjia e vlerësimit të nevojave;
- Përcaktohen instrumentat që do të përdoren për të mbledhur informacionin e nevojshëm (pyetësorët, intervistat, fokus grupet);
- Përcaktohet mënyra se si do të mblidhen të dhënat, p.sh rishikim i të dhënave egzistuese, fokus grupe, vëzhgime në terren etj;
- Përcaktohet mënyra e se si do të analizohet informacioni që do të mblidhet;
- Saktësohet mënyra se si do të përmbledhet informacioni i marrë dhe si do të paraqitet në një raport përfundimtar.

Të gjitha çështjet e mësipërme është e nevojshme “të saktësohen” që në fazën e përzgjedhjes së metodologjisë, me qëllim sigurimin e një bazë e fortë për të mbështetur gjetjet e identifikuar në përfundim të procesit të vlerësimit të nevojave.

Fillimisht para se të realizojmë një studim për vlerësimin e nevojave, duhet të adresojmë disa çështje kryesore, të tilla si:

- Duhet të përcaktohet më parë popullata (në rastin tonë grupet rinore dhe veçanërisht të rinjtë vulnerabël) ku do të kryhet ky vlerësim nevojash, duke patur në konsideratë edhe kufijtë gjeografikë ku jeton ky target grup;
- Duhet të identifikohen burimet aktuale pasi vlerësimi i nevojave nuk duhet të përqendrohet vetëm në problemet/shqetësimet apo mungesat e anëtarëve të komunitetit. Gjithashtu duhet të identifikohen anët pozitive, pikat e forta dhe burimet ekzistuese të komunitetit. Kjo u jep mundësi anëtarëve të komunitetit të shprehin mendimet/opinionet e tyre mbi pikat e forta. Përveç kësaj, pikat e forta, burimet në komunitet mund të përdoren gjatë procesit të vlerësimit të nevojave (p.sh. kapacitete të caktuara të organizatave të ndryshme mund të ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave apo në mbështetjen/sponsorizimin e forumeve publike në komunitet).

Struktura e procesit të vlerësimit të nevojave dhe metodat

Vlerësimi i nevojave është një proces sistematik për të përcaktuar dhe adresuar nevojat, ose "mungesat". Vlerësimi i nevojave është pjesë e procesit të planifikimit. Procesi i vlerësimit të nevojave ndihmon për të përcaktuar natyrën dhe shtrirjen e problemit, si dhe ndihmon për të kuptuar se si perceptohen problemet nga anëtarët e grupit të synuar.

Gjashtë janë metodat kryesore për vlerësimin e nevojave:

- Teknika e përdorimit të informacionit ekzistues;
- Pyetësorët;
- Intervistat me persona kyç;
- Fokus grupet;
- Vëzhgimi;
- Forumet komunitare.

Për të realizuar procesin e vlerësimit të nevojave përdoren metoda gjithpërfshirëse, të besueshme, të lehta për t'u menaxhuar dhe që sigurojnë informacion të pasur cilësor dhe sasior. E rëndësishme është të merren në konsideratë se cilat burime janë të mundshme për vlerësimin e nevojave, kohën e përfundimit të këtij vlerësimi, saktësinë dhe besueshmërinë e tij. Më poshtë janë të shpjeguara në detaje secila nga metodat e mbledhjes së të dhënave që mund të përdoren për një vlerësim të plotë nevojash.

Teknika e përdorimit të informacionit ekzistues

Në çdo komunitet gjendet një pafundësi informacioni, nëse ju dini se ku ta kërkonit atë. Përpara se të fillohet të mbledhen të dhëna të reja, më parë duhet të bëhet një kontroll për të parë se çfarë të dhënash ekzistojnë. Kjo jo vetëm do të ndihmojë në një njohje më të shpejtë të problemit, por gjithashtu të kursen kohë dhe para më vonë. Planet dhe studimet ekzistuese me të dhëna mbi target grupin shpesh japin një pamje të qartë për të cilën shumë qytetarë nuk e dinë se ekziston.

Institucione të ndryshme si drejtoritë e statistikave në nivel Bashkie apo Qarku, zotërojnë dhe publikojnë informacion rreth numrit të popullsisë, strukturës së saj (përbërje, numër, shpërndarje) si dhe të dhëna të tjera demografike (lindjet, vdekjet, arsimimi punësimi, emigracioni, etj). Gjithashtu, gjenden informacion në lidhje me situatën sociale, arsimore, ekonomike dhe shëndetësore të popullsisë. I gjithë ky informacion dhe të dhëna të tjera gjenden të publikuara në forma të ndryshme si në buletinë periodikë, (3 mujor, 6 mujor, vjetor) studime të popullsisë së përgjithshme që bëhen çdo 10 vjet, etj.

Avantazhet e kësaj metode lidhen me faktin se janë të vlefshme dhe me një kosto të ulët por edhe ofron të dhëna për një diapazon të gjerë si dhe sipas karakteristikave të komunitetit si: popullsia, numri i familjeve, sociale, ekonomike, shëndetësore, biznesi, kulturore qeverisëse, transportit, turizmit, etj.

Lista e mëposhtme përmban elementët që duhet të marrim parasysh gjatë përzgjedhjes së metodologjisë

Udhëzimi i vlerësimit për zgjedhjen e metodës/ave	
Informacioni dhe qëllimi i kërkuar	Vendimi që do të marrin përdoruesit bazuar mbi rezultatin e të dhënave të mbledhura dhe pyetjeve korespondente që udhëzojnë mbledhjen e të dhënave (p.sh, disa pyetje kërkojnë të dhëna cilësore dhe sasiore)
Preferencat e përdoruesve	Cilat të dhëna janë më të bindshme për përfituesit dhe partnerët? Ku ndryshojnë ato? Preferencat e kujt do të kenë përparësi?
Informacioni i mundësuar	Si është mbledhur informacioni egzistues? A mund të përdoren metodologji të qëndrueshme për të ndërtuar apo për të krahasuar këto të dhëna?
Niveli i saktësisë	Çfarë nivele preçizioni kërkohet për të marrë vendimet?
Mbulimi/thellësia e kërkuar	Cili është mbulimi gjeografik që kërkohet për mbledhjen e të dhënave? Cilat grupe kanë fuqi dhe status të ndryshëm brënda komunitetit? (p.sh, gjinia, pasuria, mosha, etnia, aftësia e kufizuar).
Afati kohor	Kur u duhen rezultatet vendimmarrësve? A përjashton ndonjë metodë afati kohor?
Burimet njerëzore	Cilat eksperiencë apo aftësi mundësohen? A mund të rekrutohen apo të kontaktohen burime të tjera njerëzore? A do të kërkohet trajnim i mëtejshëm?
Burimet financiare	Sa do të kushtojë mbledhja e të dhënave? Konsideroni gjithashtu koston e mundësisë, ndikimit dhe aktivitetet të tjera të burimeve për mbledhjen e të dhënave (p.sh, përdorimi i automjeteve, përkthyes, materiale logjistike, etj).

Pyetësorët

Pyetësorët janë një teknikë unike pasi është e vetmja teknikë e vlerësimit të nevojave, e cila ka potencialin e përfaqësimit të gjithë njerëzve në një komunitet. Nëse një pyetësor është i mirë hartuar dhe zbatuar, rezultatet mund të përdoren për një masë të gjerë të popullsisë.

Anketa bazohet mbi informacionin e mbledhur nga një grup i përzgjedhur në mënyrë rastësore nga totali i popullsisë. Nga ana tjetër, ata mund të administrohet nga të gjithë njerëzit në një komunitet apo organizatë për të siguruar që çdo kush të ketë mundësinë për të shprehur vetveten. Metodatat më të përdorshme të plotësimit të pyetësorëve janë pyetësorët ballë për ballë, dorëzimi dhe plotësimi i pyetësorit nga vetë i anketuari, dërgimi i pyetësorit me postë, plotësimi online nëpërmjet një linku pyetësori të krijuar apo plotësimi me telefon. Megjithatë çdo formë e plotësimit të pyetësorit të përmendur më sipër është e ndryshme, formati është i njëjtë.

Lidhur me llojin e pyetjeve që mund të bëhen në pyetësorë, mund të jenë pyetje të strukturuar dhe të përqendruara tek përgjigjet e mbyllura Po ose Jo, ose alternative zgjedhjesh si dhe pyetje të hapura që i lënë mundësi të anketuarit të shprehet. Megjithatë, pyetësori duhet të jetë i ndjeshëm ndaj barrierave psikologjike, shtrirjes së temave, fjalori i përdorur, llojin e personave që e administrojnë atë, elementë, të cilët mund të kenë efekt tek përgjigjet.

Duhet patur në vëmendje qëllimi përse ky informacion dhe analizë po zhvillohet, duke pasur kujdes që të limitohet në specifikimin dhe qartësimin e nevojave të identifikuara.

Avantazhet

- Mund të jetë i lirë, veçanërisht në rastet kur përfshihen vullnetarë.
- Vetëm nëpërmjet të dhënave të mbledhura në një grup të vogël popullsie mund të sigurosh dhe përgjithësosh informacionin për të gjithë popullsinë.
- Teknikat – intervistim nëpërmjet postimit, telefonatave, intervistave personale, dorëzimit dhe grumbullimit të pyetësorëve, mund të përzgjidhen në përputhje me mundësitë financiare dhe koston e programit.
- Mund të shërbej për të anketuar të gjithë popullsinë (target grupin e synuar) dhe ofrojë një mundësi për shumë persona të përfshihen në proceset vendimmarrëse.
- Mund të përdoret për të regjistruar sjellje, si dhe opinione, qëndrime, njohuri dhe besime.
- Mund të kombinohet me metoda të tjera të cilat mund të japin informacion më të detajuar.

Disavantazhet

- Për të siguruar informacion të saktë statistikor, personat që do të përfshihen duhet të përzgjidhen me kujdes.
- Rezultatet mund të jenë të padobishme nëse pyetësori nuk hartohet siç duhet.
- Mund të kërkojë kohë dhe ekspertizë për të hartuar pyetësorin, për të trajnuar administartorët e pyetësorëve, dhe analizuar të dhënat.
- Mund të ketë vend për keqinterpretime nëse pyetjet dhe kategorizimi i tyre nuk është bërë siç duhet.

Intervistat gjysëm të strukturuar me persona kyç

Metoda e intervistimit të personave kyç është e bazuar në marrjen e informacionit, nga banorë të komunitetit të cilët janë në një pozitë që e njohin mirë komunitetin e tyre dhe target grupin e synuar. Ata janë anëtare të komunitetit të cilët shihen si individë me influencë në komunitetin e tyre pasi ata kanë njohuri të thella për komunitetin, shërbimet që ofrohen aty, dhe njerëzit e tij. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për të marrë informacion për ngjarje që kanë ndodhur në të kaluarën dhe që nuk mund të vëzhgohen më.

Objektivat e vlerësimit të nevojave mund të ndihmojnë për të përcaktuar personin më të përshtatshëm për të qene “Person Kyç”. Në këtë grupim futen personat që punojnë në institucione qendrore apo vendore dhe janë njohës të mirë të fushës. Pak njerëz mund të jenë në gjendje të flasin për çdo gjë, prandaj duhet që të jeni të qartë për problemin apo çështjen që do trajtoni në mënyrë që të zgjidhni personin kyç të duhur. Në rastet e problematikave të të rinjve dhe veçanërisht për të rinjtë vulnerabël, persona kyç janë ofruesit e shërbimeve në nivel vendor dhe qendror, OSHC-të, familjarët e tyre dhe vetë grupi i synuar.

Struktura e intervistës

Zakonisht intervista fillon me diskutime joformale. Kjo metodë kërkon kohë të mjaftueshme për të fituar besimin e personit kyç për të ndërtuar një marrëdhënie besimi. Cilësia e informacionit do të varet nga aftësia e intervistuesit për të drejtuar bisedën në mënyrë të tillë që të marrë nga personi kyç informacionin e nevojshëm.

Mund të përdoren një numër metodash për të punuar me personat kyç. Pyetjet mund të hartohen që më parë, në formën e një interviste ose duke mbajtur parasysh disa shënime që të ndihmojnë për të drejtuar dhe ndjekur intervistën. Megjithatë, në rastet kur intervistuesi është një njohës i mirë i çështjes për të cilën po mbledh informacion mund të zhvilloj dhe një bisedë spontane.

Kjo metodë është veçanërisht e dobishme në rastet kur:

Kërkohet të ketë një informacion të thelluar për një pikëpamje, të konsideruar si një çështje delikate për komunitetin por që e prek komunitetin për një kohë të gjatë.

Kërkohet një përqasje e personave njohës të komunitetit mbi problemin që do të adresohet.

Përfshirja e qytetarëve në zgjidhjen e një problemi publik i cili nuk mund të trajtohet me anë të pyetësorit.

Avantazhet

- Të jep mundësi të marrësh pikëpamje dhe qëndrime nga persona direkt të përfshirë në problematikën që studiohet;
- Plotësimin e informacionit me gjykime dhe arsyetime të thelluara;
- Të jep mundësi të sqarosh më tej idenë dhe pasurosh më shumë informacionin;
- Mund të kombinohet lehtësisht me teknika të tjera;
- Lejon ndërthurjen me shumë individë të tjerë;
- Mund të kryhet nga punonjës të komunitetit, duke rritur përfshirjen dhe ndërgjegjësimin e komunitetit;
- Nuk ka një kosto të lartë.

Disavantazhet

- Kërkon kohë për të zgjedhur personin kyç më të mirë dhe për të ndërtuar marrëdhënien e besimit;
- Vendosija e marrëdhënieve personale midis personit kyç dhe intervistuesit mund të ndikojnë në përpunimin e të dhënave të grumbulluara;
- Të dhënat mund të kenë vështirësi në përpunim duke qene se është një metodë cilësore;
- Gjeneron të dhëna të cilat nuk mund ti përgjithësosh;
- Duhet të kombinohet domosdoshmërisht me metoda të tjera, pasi përfaqësimi i të gjithë tagetit të synuar është i vështirë të realizohet.

Fokus grupet

Fokus grupet janë metoda më e përdorshme në vlerësimin e nevojave apo vlerësimin e një problematike të caktuar. Nëpërmjet fokus grupeve inkurajohet më shumë hapja e pjesëmarrësve dhe sigurohet një informacion më i gjërë dhe kompleks. Përmes tij, pjesëmarrësit stimulojnë njëri-tjetrin me ide dhe mendime. Kjo është një metodë relativisht e shpejtë dhe e përshtatshme për të mbledhur të dhëna nga disa individë njëkohësisht. Fokus grupet mund të jenë të dobishme, kur qëllimi i vlerësimit të nevojave është të marrë të dhëna nga disa njerëz, të cilët shpesh janë së bashku në situatë, problematika apo detyra të përbashkëta. Për këtë arsye, fokus grupi shikohet si një instrument i përshtatshëm gjatë vlerësimit të nevojave, pasi ndihmon në stimulimin e diskutimeve rreth problemeve, nevojave dhe pikave të forta në jetën e anëtarëve të komunitetit.

Struktura e fokus grupeve

Fokus grupet mund të zhvillohen nga grupe të ndryshme të komunitetit si p.sh : shoqëri civile me përfaqësues të shoqatave të ndryshme të cilët interesohen rreth shërbimeve dhe mangësive që ekzistojnë në sistemin e shëndetësisë, arsimit, grupe prindërisht, mësuesish, grupe ambientaliste, grupe biznesesh, të rinj/reja vulnerabël etj.

Për shkak të përbërjes homogjene të një grupi, sugjerohet që të njëjtat tema të diskutohen në fokus grupe të ndryshme duke lejuar kështu mbledhjen e një informacioni të gjerë dhe të balancuar.

Si të përgatitet një fokus grup?

- Përgatitet fillimisht një listë për të gjithë pjesëmarrësit që do të jenë pjesë e fokus grupit. Kjo letër duhet të përmbajë të dhëna për identitetin e pjesëmarrësit (emër, mbiemër, numër telefoni, adresë). Fokus grupi nuk duhet të ketë më shumë se 8 deri 10 pjesëmarrës.
- Përcaktohet gjithashtu data dhe vëndi se kur do zhvillohet fokus grupi, kohëzgjatja e tij e cila nuk duhet të jetë më shumë se 2 orë.
- Kontaktohet/telefonohet (në varësi të mundësive) çdo pjesëmarrës i mundshëm në fokus grup dhe i kërkohet që të konfirmojë pjesëmarrjen e tij. Gjithmonë duhet ti përshkruhet shkurtimisht qëllimi i fokus grupit.
- Caktohet një moderator, i cili do të udhëheqë diskutimin. Ky person mund të jetë një nga anëtarët e organizatave partnere, që janë pjesë e grupit bashkëpunues, në mënyrë që duket si një “person i huaj” dhe pjesëmarrësit të mos ndihen të kërcënuar apo në rrezik.
- Caktohet gjithashtu një lehtësues për të mbajtur shënime gjatë zhvillimit të diskutimit, ose të mbajë regjistrimet audio.
- Planifikohen pushime gjatë seancave të zhvillimit të fokus grupit.
- Dërgojini pjesëmarrësve një ftesë ku janë të shkruara shkurtimisht qëllimi i zhvillimit të fokus grupit dhe njëkohësisht atë të vlerësimit të nevojave.
- Telefonojuni ose kontaktojini pjesëmarrësit një ditë para organizimit të fokus grupit.
- Pasi pjesëmarrësit të kenë arritur jepini të nënshkruajnë një format aprovimi për pjesëmarrjen e tyre.
- Krijoni një hapësirë kohore prej 15 minutash në fillim të takimit, ku pjesëmarrësit mund të prezantohen dhe njihen me njëri – tjetrin.

Duhet mbajtur gjithmonë në vëmendje:

Lehtësuesit/moderatorët duhet të njohin dhe të jenë të familjarizuar më parë me çështjet, që janë të rëndësishme për stafin e agjencisë/organizatës/institucionit. Këto çështje duhet të reflektojnë tema të rëndësishme si p.sh cilësia e shërbimeve sociale për të rinjtë vulnerabël aksesit ndaj shërbimeve, mundësitë për argëtim dhe socializim të grupeve të të rinjve të qytetit/zonës, të cilat janë edhe në fokus të vlerësimit të nevojave.

Pasi pjesëmarrësit në fokus grup janë familjarizuar me njëri tjetrin, moderatori prezantohet si lehtësuesi i këtij procesi dhe fton të gjithë pjesëmarrësit të prezantohen. Më pas në mënyrë koncize përshkruhet procesi i vlerësimit të nevojave, qëllimi i tij, si dhe cili është roli i fokus grupeve në të. Gjithashtu është e nevojshme që pjesëmarrësit të jenë të informuar mbi faktin se diskutimet e tyre do regjistrohen, dhe se do të duhet dhe të mbahen shënime, por gjithçka do jetë konfidenciale, duke respektuar çdo parim të etikës dhe konfidencialitetit. Nëse ndonjë nga pjesëmarrësit nuk është dakort me regjistrimin e diskutimit të tij, është mirë që kjo çështje të bëhet menjëherë e ditur. I duhet dhënë përgjigje çdo pyetjeje që pjesëmarrësit mund të kenë.

Në vëmendje

- Edhe pse moderatori/ja drejton diskutimin, duhet të lejojë pjesëmarrësit të shprehin idetë dhe mendimet e tyre.
- Të sigurohet se nuk po devijohet tema;
- Të mos lejojë që një person të dominojë diskutimin dhe të inkurajojë ata që nuk kanë folur deri në atë kohë për të shprehur opinionin e tyre;
- Të tregojë vazhdimisht se është duke i dëgjuar pjesëmarrësit nëpërmjet bërjes së një përmbledhje të asaj që është diskutuar deri në atë kohë, duke bërë pyetje që konfirmojnë saktësinë e asaj çka është përmbledhur;
- Moderatori/ja shënon çdo detaj të procesit, kohën, vendin, numrin e pjesëmarrësve në fokus grup.

Mbyllja e diskutimit në fokus grup

Para se të përfundojë fokus grupi moderatori duhet të bëjë një përmbledhje të shpejtë të atyre çështjeve që janë diskutuar duke nxjerrë në pah disa nga pikat kryesore.

Në fund të diskutimit moderatori falënderon të pranishmit dhe i informon ata për hapat e tjerë që do të pasojnë procesin e vlerësimit të nevojave. Nëse pjesëmarrësit duan më shumë informacion rreth mënyrave se si ata mund të ndihmojnë/kontribuojnë më shumë në këtë proces mund t'i referoni tek drejtuesit dhe aktorët e përfshirë në vlerësimin e nevojave. Kjo është një mënyrë e mirë për të siguruar pjesëmarrjen vullnetare të disa anëtarëve të komunitetit në fazat e mëvonshme të procesit të mbledhjes së të dhënave. Gjithashtu ata duhet të njoftohen edhe për kohën kur gjetjet/rezultatet do të jenë gati dhe nëse do të ketë takime të mëvonshme për të njëjtin qëllim.

Mbyllja e diskutimit në fokus grup

Para se të përfundojë fokus grupi moderatori duhet të bëjë një përmbledhje të shpejtë të atyre çështjeve që janë diskutuar duke nxjerrë në pah disa nga pikat kryesore.

Në fund të diskutimit moderatori falënderon të pranishmit dhe i informon ata për hapat e tjerë që do të pasojnë procesin e vlerësimit të nevojave. Nëse pjesëmarrësit duan më shumë informacion rreth mënyrave se si ata mund të ndihmojnë/kontribuojnë më shumë në këtë proces mund t'i referoni tek drejtuesit dhe aktorët e përfshirë në vlerësimin e nevojave.

Kjo është një mënyrë e mirë për të siguruar pjesëmarrjen vullnetare të disa anëtarëve të komunitetit në fazat e mëvonshme të procesit të mbledhjes së të dhënave. Gjithashtu ata duhet të njoftohen edhe për kohën kur gjetjet/rezultatet do të jenë gati dhe nëse do të ketë takime të mëvonshme për të njëjtin qëllim.

Avantazhet

- Fokus grupet mund të ofrojnë një informacion të konsiderueshëm, për një kohë të shkurtër;
- Pjesëmarrja e gjerë në grup i bën anëtarët të shprehën më lirshëm pasi ndajnë të njëjtat shqetësime;
- Të lejon të shikosh edhe qëndrimin që kanë antarë të ndryshëm të komunitetit mbi çështjen dhe sesi komportohen ato me njëri tjetrin;
- I lehtë për tu menaxhuar dhe përpunuar të dhënat.

Disavantazhet

- Fokus grupet janë një zgjedhje jo e duhur nëse kërkohen të dhëna sasiore;
- Diskutimi në grup mund të dominohet nga disa persona dhe disa të tjerë mund të mos kenë mundësi të shprehën;
- Numri i vogël i pjesëmarrësve mund të lërë jashtë procesit persona të tjerë anëtarë të target grupit të synuar.

Vëzhgimi

Vëzhgimi përfshin vëzhgimin e objekteve, proceseve, marrëdhënieve, ose individëve dhe regjistrimin e këtyre vëzhgimeve. Vëzhgimi është i dobishëm kur informacioni që ne duam lidhet me gjëra/situata të vëzhgueshme dhe/ose ne kemi nevojë për të kontrolluar shpjegimet/arsyet e individëve rreth asaj çfarë që ndodh.

Avantazhet

- Drejtpërdrejt regjistron atë se çfarë bëjnë individët në dallim nga ajo që ata thonë se bëjnë.
- Mund të jetë sistematik dhe rigoroz.
- Mund të prodhojë sasi të madhe informacioni në një kohë mjaft të shkurtër.
- Mund të gjenerojë informacion, i cili më pas mund të formojë bazën për diskutim me të vëzhguarit.

Disavantazhet

- Fokusohet në sjelljen e dukshme dhe për këtë arsye nuk identifikon motivacionet e individëve.
- Rreziku që të çon tek mbi thjeshtësimi apo shtrembërimi i kuptimit të situatës.
- Prania e vëzhguesit nuk mund të ndihmojë por të ndikojë deri në një masë mjedisin e vëzhguar.
- I kushtueshëm.

Forumet komunitare

Një forum komunitar bazohet në një apo më shumë takime në publik në të cilat qytetarët janë të ftuar për të shprehur mendimet e tyre rreth problemeve dhe nevojave të komunitetit të cilat synohen të adresohen nëpërmjet programeve të caktuara.

Nëse ka një plan paraprak dhe një ekip i cili ndihmon për të realizuar forumin komunitar, mund të arrihet që në një periudhë kohe të shkurtër dhe me shumë pak kosto të mbledhet një sasi e madhe informacioni. Një drejtues/e i/e aftë dhe një organizim paraprak është i nevojshëm për të motivuar një përfaqësim gjithëpërfshirës të grupit të synuar, për të siguruar një pjesëmarrje maksimale, për të mbledhur informacion, dhe për të ditur se ç'të bëhet me informacionin pasi ai është mbledhur.

Ky format mund të shkrijë një numër teknikisht të vlerësimit të nevojave, siç mund të jenë procesi i takimeve me personat kyç, komitetet këshilluese, dëgjesat publike, dhe ndoshta një anketim në ndjekje. Ai ka potencialin që të identifikojë një problematikë mbi të cilën mund të punohet më vonë më në hollësi me një metodë tjetër; për të ndërtuar dëgjesën publike të një çështje komplekse, i hap rrugë studimeve të mëtejshme, për të projektuar programe dhe shërbime të përmirësuara, ose të testojë këndvështrimet e publikut mbi zgjidhjet e propozuara për problemet e komunitetit.

Në forume ftohen të marin pjesë antarë të ndryshëm të komunitetit me prejardhje dhe background të ndryshëm të cilët janë të interesuar mbi problemin që po vlersohet apo nevojën që do të adresohet

Avantazhet

- I jep mundësi njerëzve nga të kaluara të ndryshme të ndajnë ide dhe eksperiencë;
- Mund të sigurojë në mënyrë të shpejtë dhe intensive një panoramë të çështjeve që shqetësojnë target grupin/komunitetin;
- Në mënyrë efektive mund të përfshijë qytetarët në planifikim, vlerësim, ndërgjegjësim, etj;
- U jep çështjeve të komunitetit një shpërndarje dhe transparencë më të madhe;
- Qytetarët ndjejnë se ata janë dëgjuar;
- Jo e shtrenjtë dhe e dobishme për të identifikuar problemet, vlerësuar nevojat, apo për të sugjeruar pyetje që kërkojnë studime të mëtejshme;
- Projektimi është fleksibël – mund të ndërthuren disa teknika.

Disavantazhet

- Kërkon një drejtim të mirë dhe organizim paraprak;
- Opinione e marra mund të jenë të kufizuara – jo të gjitha mendimet mund të arrihen të dëgjohen;
- Një planifikim i dobët dhe mos njoftim i duhur mund të rezultojë në pjesëmarrje të kufizuara;
- Nëse nuk lehtësohet (organizohet) mirë vetëm një grup i vogël personash do të dëgjohen;
- Mendimet që do të merren janë të kufizuara vetëm tek të pranishmit – jo të gjitha këndvështrimet mund të merren në konsideratë;
- Gjatë diskutimeve mund të dalin më shumë pyetje sesa përgjigje;
- Mund të rrisë stresin apo pritshmëritë tek të pranishmit nëse objektivat janë të paqartë, apo nëse ato që priteshin nuk janë arritur.

Kush mund të kryejë një vlerësim nevojash?

Hapi i parë në kryerjen e një vlerësimi nevojash ka të bëjë me përcaktimin se kush do t'a kryejë këtë proces. Ky proces mund të realizohet nga konsulentë të jashtëm, nga vullnetarë ose nga vetë stafi i organizatave, agjensive, institucioneve apo dhe vetë njësisë të qeverisjes vendore. Kjo ndikohet nga burimet që janë në dispozicion të këtij procesi, nga afatet kohore për kryerjen e tij.

Konsulentët e jashtëm kanë ekspertizën e nevojshme për të realizuar një vlerësim nevojash. Ata sigurojnë objektivitet në kryerjen e këtij procesi, duke qenë “persona jashtë komunitetit” dhe “jashtë agjensive/institucioneve”. Kryerja e vlerësimit të nevojave nga një konsulent i jashtëm, sigurisht që kursen kohën e punonjësve të organizatës / agjensisë / institucionit, por disavantazhi kryesor i përfshirjes së konsulentëve është kostoja financiare e punës së tyre. Konsulentët janë opsioni më i shtrenjtë, krahasuar me opsionet e tjera.

Vullnetarët nga komuniteti janë një tjetër mundësi për t'u përfshirë në procesin e vlerësimit të nevojave. Përfshirja e tyre sjell disa avantazhe. Ata nuk kanë kosto financiare ose kanë një kosto minimale. Angazhimi i tyre kursen kohën e stafit. Një nga disavantazhet e përfshirjes së vullnetarëve në procesin e vlerësimit të nevojave të komunitetit është se ata mund të japin një interpretim të njëanshëm të asaj që komuniteti ka nevojë.

Pra, është e rëndësishme të zgjidhen vullnetarë të cilët e përfaqësojnë komunitetin në një dimension të gjerë. Përveç kësaj, mund të jetë e vështirë të gjenden vullnetarë, të cilët mund të jenë të gatshëm t'ia kushtojnë kohën e tyre këtij procesi, por ajo që është më e rëndësishme të kenë përvojën e nevojshme për të realizuar një vlerësim nevojash.

Anëtarët e stafit mund të kryejnë një vlerësim nevojash. Përfshirja e tyre kërkon më pak kosto se sa rekrutimi i një konsulenti, por ato mund të mos kenë përvojë në përdorimin dhe zbatimin e metodave kërkimore apo kohë në dispozicion për të realizuar këtë proces, ndërkohë që mund të kenë një sërë detyrash të tjera për të zbatuar. Në këto raste është e nevojshme të reduktohen disa prej detyrave dhe përgjegjësive të tjera që punonjësit kanë. Duhet të analizohen avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej mënyrave të lartpërmendura. Shpesh, buxheti është faktori kryesor që kufizon zgjedhjet. Por një kombinim i këtyre metodave mund të jetë një zgjidhje e mirë.

Kombinim i këtyre metodave mund të jetë një zgjidhje e mirë. Për shembull, mund të rekrutohet një konsulent i jashtëm për të ofruar ekspertizën e tij në ndërtimin e instrumentave të kërkimit të nevojshme në procesin e vlerësimit të nevojave, si dhe të angazhohen vullnetarë nga komuniteti për të zbatuar dhe përdorur këto metoda. Ndarja e roleve dhe përgjegjësive, duke shfrytëzuar edhe kreativitetin, idetë e reja e aftësitë praktike mund të çojë drejt realizimit të një procesi vlerësimi nevojash me një kosto-efektive.

Metoda të përdorimit të të dhënave në funksion të profesionistëve dhe të informimit publik..

Strategji dhe ndërhyrje që ndikojnë në zgjerimin e pjesëmarrjes qytetare në qeverisjen vendore

Planifikimi pjesëmarrës

Metodologjia e planifikimit pjesëmarrës i ofron njerëzve mundësinë e përfshirjes së tyre në hartimin e planeve për zhvillim ekonomik dhe social me qëllim që të influencojnë në prioritetet e vendosura nga qeveria lokale.



Rritja e edukimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve

Një tjetër strategji, është përdorimi i metodologjive të njohura të edukimit dhe komunikimit, me synim rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë që ata kanë në kuadër të legjislacionit të qeverisjes vendore. Si psh:

- Takime informuese në komunitet;
- Seminare;
- Broshura informuese;
- Emisione në televizione lokale;
- Informim nëpërmjet faqeve të internetit, mediat sociale, etj.

Trajnimi dhe sensibilizimi i zyrtarëve vendor/ofruesve të shërbimeve sociale

Ndërsa, disa metoda edukimi fokusohen në ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapacitetit të qytetarëve, metoda të tjera përfshijnë trajnimin e zyrtarëve të zgjedhur apo administratës, duke i fuqizuar dhe aftësuar këta të angazhohen me qytetarët duke përdorur metoda sa më gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse. Si psh:

- Organizimi i trajnimeve;
- Tryeza të rrumbullakëta;
- Workshope fuqizuese;
- Manuale dhe udhëzues pune, etj.

Advokaci/Përkrahje, aleanca dhe bashkëpunime

Edukimi i aftësive për të ofruar përkrahje dhe për të krijuar aleanca apo partneritet bashkëpunues, është e rëndësishme të ofrohet në ato kontekste ku përfshihen diferenca në pushtet.

Nga njëra anë, qytetarët, organizatat lokale, OSHC-të, të përjashtuara më parë nga procesi i vendimmarrjes qeveritare, kanë nevojë të mësojnë aftësi lidhur me përkrahjen dhe influencën efektive në politika, si dhe njëkohësisht të kenë aftësinë për të ruajtur pavarësinë e tyre.

Në anën tjetër, zyrtarët dhe autoritete të tjera që mbartin pushtet, kanë nevojë të përvetësojnë njohuri dhe të zhvillojnë mekanizma të përshtatshëm për përfshirjen e aktorëve të tjerë në formulimin e politikave dhe në procesin e vendimmarrjes.

Buxhetimi pjesëmarrës

Një nga eksperiencat më të suksesshme në pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal, është buxhetimi pjesëmarrës, i cili lejon pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes lidhur me shpërndarjen e burimeve.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një qasje e cila i'u mundëson qytetarëve dhe organizmave vendore të një juridiksioni të caktuar të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e burimeve dhe financave publike të pushtetit vendor. Më specifikisht:

- Buxhetimi pjesëmarrës është një proces demokratik, i cili aftëson anëtarët e një komuniteti të caktuar të ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën sesi do të përdoret buxheti.
- Përmes buxhetimit pjesëmarrës, qytetarët janë më të përfshirë në procesin e vendimmarrjes qytetare, si mënyrë për të adresuar nevojat e tyre kolektive.
- Buxhetimi pjesëmarrës, është një mjet që ndihmon dhe lehtëson qeverinë vendore në shpërndarjen dhe administrimin e buxhetit të Bashkisë apo Njesisë Administrative
- Strukturat dhe këshillat e zgjedhur, gjenerojnë mundësi dhe mënyra të reja për të marrë vendime në bashkëpunim me komunitetin dhe jo vetëm vendime nga ata.
- Grupet në nevojë kanë zërin e tyre në qeverisjen vendore, përfshihen dhe fuqizohen për të vepruar nëpërmjet buxhetimit pjesëmarrës.

Aktorët kryesorë në këtë proces janë:

Qytetarët, të cilët diskutojnë dhe vendosin sesi të përdoren fondet vendore, shpenzimet kapitale dhe projektet operative në nivel komunitar, vendor, rajonal dhe më gjerë.

Administrata e Bashkisë apo Njesisë Administrative, lehtëson diskutimet dhe ofron asistencë teknike në procesin e buxhetit.

Kryetari i Bashkisë, propozon dhe paraqet buxhetin pjesëmarrës pranë këshillit bashkiak për të miratuar buxhetin final.

Komisionet Bashkiake dhe Këshilli Bashkiak i cili merr vendimin përfundimtar për miratimin ose jo të projekt buxhetit të paraqitur.

[illegible]



PËRFUNDIME

Mbështetja sociale për të rinjtë në vështirë është e domosdoshme të mbështetet në një kuadër ligjor dhe institucional gjithëpërfshirës. Por, politikat për të rinjtë jo vetëm që duhet të mbrojnë të drejtat dhe mirëqenien e të rinjve, por, gjithashtu, duhet të veprojnë si një strukturë udhëzuese për ofrimin e shërbimeve.

Komunikimi efektiv qëndron si shtylla kryesore e punës me të rinjtë në vështirësi. Nëpërmjet komunikimit të qartë dhe empatik, besimi dhe mirëkuptimi janë më të forta, duke bërë të mundur mirëqenien fizike dhe emocionale të të rinjve në vështirësi. Bashkëpunimi dhe ndërtimi i partneritetit janë po aq thelbësorë, duke krijuar një rrjet gjithëpërfshirës dhe mbështetës që përfshin aktorë të ndryshëm, si familjen, shkollat dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve. Gjithashtu, duke patur një qëndrim të hapur ndaj metodave inovative të kërkimit dhe aktivizmit social mund të sjellim perspektiva dhe zgjidhje të reja në punën me të rinjtë.

Mirëqenia e të rinjve është një përgjegjësi e përbashkët brenda komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi. Informimi i vazhdueshëm për nevojat dhe përshtatja me to bën të mundur që mbështetja e ofruar nga shërbimet sociale të mbetet e rëndësishme dhe efektive.

Në qëndër të vëmendjes së punës sonë është fuqizimi dhe mirëqenia e jetës së të rinjve. Çdo ndërveprim paraqet një mundësi për të krijuar një ndikim të thellë dhe pozitiv tek të rinjtë.

Përkushtimi, empatia dhe angazhimi i punonjësve socialë dhe i profesionistëve të çështjeve sociale luajnë një rol kyç në formësimin e një jetese më të shëndetshme për të të rinjtë, duke hapur rrugën për një të ardhme shpresëdhënëse.





Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë